

Hajrije Devetaku  
Selim Mehmeti

## VLERËSIMI I NXËNËSVE – PRAKTIKAT DHE TREGUESIT

### **Abstrakt**

Hulumtimit është kryer nga Sektori i Planifikimit Mësimor/Zyra për Standarde dhe Vlerësim, në kuader të projekteve inicuese të Institutit Pedagogjik të Kosovës 2007/2010. Hulumtimi përfshin praktikat aktuale të vlerësimit të brendshëm. Rezultatet e hulumtimit do të ofrojnë tregues dhe argumente për te ndihmuar dhe orientuar drejtimet kryesore që e avancojnë procesin e vlerësimit tek ne dhe e bëjnë atë të krahasueshëm dhe të matshëm me vendet që kanë sistem të përafërt të edukimit.

Procesi i reformës arsimore në Kosovë ka filluar nga vitit 2001. Ekspertiza ndërkombëtare ka ndihmuar hapjen e sistemit arsimor drejt trendeve bashkëkohore ndërkombëtare. Reforma arsimore, përveq strukturës së arsimit ,ka përfshirë edhe kornizën e kurrikulit, pra edhe procesin e vlerësimit. Në këtë proces janë hartuar udhëzime administrative që rregullojnë procesin e vlerësimit, ka filluar edhe implementimi i vlerësimit të jashtëm në fund të niveleve të shkollimit, përkatësisht në fund të klasës së pestë, në fund të klasës së nëntë-testi i arritëshmerisë, si dhe testi i maturës në fund të shkollës së mesme të ulët. Rezultatet nga vlersimi i jashtëm jënë mjaft të ulëta dhe nuk korrespondojnë me rezultatet nga vlerësimi i brendshëm.

Edhe pse kanë kaluar disa vite nga kjo traditë, perspektivat në këtë drejtim nuk janë të kënaqëshme. Prandaj, hulumtimi i kësaj fushe

është më interes të veçantë, sepse do t'u ndihmojë të gjithë atyre që merren me këtë fushë, me theks të posaçëm atyre që në praktikat shkollore sfidohen në mënyra të ndryshme. Rëndësia e hulumtimeve në fushën e vlerësimit lidhet edhe me përafrimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, si mundësi për të pasur qasje në vlerësimet ndërkombëtare, siç është programi ndërkombëtar PISA.

Hulumtimi është projektuar për të zbatuar një qasje të përgjithshme të metodologjisë hulumtuese, duke u bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit që rregullon procesin e vlerësimit, në dokumentimet e shkollave për vlerësimin e nxënësve, në veçanti në përpunimin e informacionit të marrë nëpërmjet takimeve me fokus grupet e interesit, si dhe nëpërmjet pyetësorëve nga anketimi respondentëve nga të gjitha grupet e interesit të përcaktuar për përfshirje në hulumtim.

Rezultatet nga hulumtimi ynë konfirmojnë se përkundër disa përparimeve në fushën e vlerësimit, vlerësimi i brendshëm i nxënësve vazhdon të jetë në "krizë". Deri te një gjendje e tillë ka ardhur si rezultat i humbjes së interesimit të nxënësve për mësim, punës jo në nivel të mësimdhënësve, mosnjohjes në thelb të kriterëve bazë të vlerësimit, presioneve që i bëhen mësimdhënësve për dhënien e notave të pamerituara, drejtuesve të shkollave që duan kalueshmëri të lartë të nxënësve me justifikim të "ngritjes" së performancës së shkollës, ruajtjes së personelit arsimor, presionit të prindërve që kërkojnë nota të pamerituara për fëmijët e tyre, numrit të madh të nxënësve në klasë dhe menaxhimit jo cilësor të procesit të vlerësimit me bazë shkolle. Këto rezultate u identifikuan gjatë dy punëtorive të organizuara me fokus grupet e interesit dhe gjatë hulumtimit në terren.

Hulumtimi në terren tregoi se rishikimi dhe vendosja e standardeve të përmbajtjes dhe standardeve të arritjes, përgatitja e udhëzuesve, doracakëve e informatorëve të ndryshëm për procesin e vlerësimit, hartimi i një programi funksional dhe koherent për aftësimin e

mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave në fushën e vlerësimit, si dhe zbatimi i teknikave të vlerësimit formativ, janë drejtimet kryesore që e avancojnë procesin e vlerësimit të brendshëm dhe e përafrojnë atë me vlerësimin e jashtëm.

## **Abstract**

The research has been conducted by the Division of Educational Planning/Office for Standards and Evaluation within initial projects of Pedagogical Institute of Kosova 2007/2010. The research has been projected in such a way to show that current internal evaluation practices are under focus.

The research results should offer indicators and arguments to help and direct main course that enhance evaluation process and make it comparable and measurable with countries that have enhanced systems of education. The reform process in Kosova has started in 2001. The international expertise helped educational system to be open towards modern international trends.

Besides educational structure, educational reform included curricula framework as well, therefore evaluation process, too. Administrative Instructions were drafted to regulate evaluation process. The external evaluation has started to be implemented at the end of educational level i. e at the end of grade 5, at the end of grade 9 (test of achievement) and the Matura Exam at the end of Higher Secondary School. The outcome from the external evaluation are very low and do not correspond with outcome from the internal evaluation.

Even though several years have passed, the perspective in this direction is gloomy. Therefore, the research in this field is of special interest because it will help all those who deal with these issues and

especially those who are challenged in different ways in the school practices. The importance of researches in the field of evaluation has to do with bringing closer the internal and external evaluation as an opportunity to have access to international evaluation such as international program for students' evaluation PISA.

The research is drafted to implement a comprehensive approach of research methodology based on document's review that regulate evaluation process, on school documents for students' evaluation and particularly on processing of information gained through meetings with target groups as well as through questionnaires from respondent interviews from all groups of interest anticipated to be included in the research.

The results from our research confirm that despite some improvements in the field of evaluation, internal evaluation of students remains in "crisis". This situation is as the result of students' low interest for learning, as the result of low quality of teachers' work, as the result of poor knowledge of basic criteria of evaluation, as the result of unjust pressure of teachers on their colleagues to enhance grades without merit, as the result of pressure by school managers who want higher percentage of students passing justifying "improvement" of school performance in order to protect school staff, as the result of parents pressure who ask for grades for their children without merit, as the result of high number of students in a classroom and as the result of poor management of school based evaluation process. These results were identified during two workshops organized with target groups and during the research on the field.

The research on the field showed that review and setting of standards of content and standards of achievement, preparation of instructions, manuals and different leaflets for evaluation process, drafting of a functional and coherent program for teachers and school managers

training in the field of evaluation as well as implementation of techniques of formative evaluation are main course that enhance internal evaluation process bringing it closer with external evaluation.

## I. Hyrje

Sistemi arsimor në Kosovë ka pasur ndryshime të rëndësishme që lidhen jo vetëm me strukturën e nivelit të shkollimit, por edhe me ndryshimet e planeve dhe programeve mësimore, teksteve shkollore, zhvillimin profesional të mësimeve dhe me qasjen e vlerësimit të arritjeve të nxënësve. Pavarësisht nga ndryshimet e bëra, vlerësimi i arritjeve të nxënësve ballafaqohet me sfida të shumta që lidhen me faktorë të ndryshëm. Këtë më së miri e tregojnë rezultatet nga vlerësimi i jashtëm në fund të klasës së pestë dhe ai në fund të klasës së nëntë-testi i arritshmerisë, si dhe testi i maturës në fund të shkollës së mesme të lartë, të cilat në një mënyrë i reflektojnë edhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen shkollat në procesin e vlerësimit të brendshëm të arritjeve të nxënësve .

Hulumtimi është orientuar në përcaktimin e disa rekomandime se ku dhe si duhet të ndërhyhet në përmirësimin e procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve, duke u bazuar në literaturën profesionale, përvojat pozitive, por edhe në propozimet relevante nga takimet me grupet e interesit dhe nga mendimet respondentëve të shprehura në pyetësorët e realizuar me ta.

Për të analizuar, argumentuar dhe prezantuar problemin e hulumtimit, paraprakisht kemi konsultuar literaturë profesionale nga fusha e vlerësimit, si dhe kemi aplikuar metodologji me qasje sasiore dhe cilësore. Te dhënat janë mbledhur përmes shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe atij shkollor për fushën e vlerësimit, nga anketimi i nxënësve, mësimeve, drejtorëve/zv.drejtorëve të shkollave, prindërve, nga intervistimi i zyrtarëve arsimor dhe

drejtorëve të shkollave dhe nga dy punëtori të organizuara me grupe të interesit. Të gjitha të dhënat i kemi përpunuar, analizuar dhe interpretuar.

Hulumtimi është realizuar nga ekipi hulumtues: Hajrije Devetaku - *hulumtuese për standarde dhe vlerësim*, Selim Mehmeti - *hulumtues për standarde dhe vlerësim*, Gani Gajraku - *hulumtues për aftësimin e personelit*, Sylejman Bërbtovci - *hulumtues për plane dhe programe mësimore* dhe Agron Mexhuani - *hulumtues për aftësimin e personelit*.

### ***Arsyetimi dhe rëndësia e hulumtimit***

Vlerësimi i shkallës së arritshmerisë së nxënësve është një nga çështjet më të rëndësishme në procesin mësimor. Nëpërmjet vlerësimit sigurohen të dhënat për nivelin e shkallës së arritshmerisë së nxënësve, realizimin e planit dhe programit mësimor dhe përmbushjes së objektivave mësimor. Për të nxjerrë një vlerësim për gjendjen ekzistuese, është e nevojshme të bëhen hulumtime dhe krahasime të rezultateve dhe të treguesve të ndryshëm që pasqyrojnë gjendjen dhe nivelin e zhvillimit të procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.

Që nga fillimi i reformimit të sistemit arsimor në Kosovë, nuk janë bërë hulumtime dhe krahasime të rezultateve dhe praktikave të vlerësimit të arritjeve të nxënësve<sup>35</sup>. Vlerësimi i nxënësve nga një nivel i shkollimit në nivelin tjetër ka dallime të mëdha, po ashtu ka dallime të mëdha të rezultateve në mes të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm. Kjo tregon se sa i rëndësishëm është fokusimi përmbajtësor në procesin e vlerësimit të nxënësve. Mendimi i faktorëve relevantë që lidhen me procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve është i rëndësishëm, sepse: *ata janë vlerësuesit më të paanshëm të gjendjes, problemeve dhe progresit që është bërë në*

---

<sup>35</sup> Instituti i Edukimit, Universiteti i Londrës në vitin 2005 ka bërë studimin: Planet dhe programet kombëtare në Kosovë – vlerësimi i hapave të parë. Në këtë studim janë përfshirë edhe qështjet e vlerësimit dhe janë dhënë rekomandime me mjaft interes në përmirësimin e kësaj fushe.

*fushën e vlerësimit.* Prandaj, në këtë hulumtim kemi planifikuar që në mënyrë të veçantë të përfshihen nxënësit, mësime të ndryshme, prindërit, drejtorët dhe zv.drejtorët e shkollave.

### *Supozimet*

Të dhënat nga hulumtimi *Vlerësimi i nxënësve – praktikat dhe treguesit* nuk duhet konsideruar si burim i vetëm për vlerësimin e gjendjes në fushën e vlerësimit të nxënësve në Kosovë. Gjetjet nga hulumtimi, përfundimet dhe rekomandimet janë një mundësi e mirë për t’ju referuar gjendjes së cilësisë së arsimit në këtë fushë. Për vlerësim më të plotë të cilësisë së arsimit dhe procesit të vlerësimit, duhet orjentuar edhe në burime tjera, si: legjislativin në fushën e arsimit/vlerësimit, programeve mësimore, teksteve shkollore, trajnimeve të mësimeve, monitorimit, vlerësimit, etj.

Do të mbetet çështje e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) që rekomandimet e dalta nga ky hulumtim t’i analizojë dhe t’i jetësojë në praktikë, duke caktuar me kohë bartësit dhe kohën e përbushjes së tyre. Ekipi hulumtues i Sektorit për Planifikim Mësimor në Institutin Pedagogjik të Kosovës është i gatshëm që të mbështes dhe të ofrojë ekspertizën e tij.

## **II. Vlerësimi i nxënësve – kuptimet themelore**

Procesi i vlerësimit të nxënësve është i lidhur ngushtë me njohjen paraprake të koncepteve bazë të tij. Ato janë të lidhura ngushtë me njëra - tjetrën, por nuk janë të njëjta. Prandaj, duke u bazuar në literaturën profesionale dhe në përvojën tonë, do të bëjmë përpjekje që lexuesve të këtij hulumtimi t’u ofrojmë disa të dhëna bazë të

vlerësimi ,sepse konsiderojmë se do të ndihmojnë në krijimin e kuptimit të lidhjes teorike dhe praktike së vlerësimit të nxënësve.

Dokimologjia është disiplinë relativisht e re shkencore, “ *e cila studion teknikën e sigurimit të informacioneve mbi bazën e të cilave realizohet vlerësimi i nxënësve*”<sup>36</sup>. Në fokus të studimit të saj janë të gjithë faktorët që lidhën me vlerësimin e nxënësve.

*Vlerësimi.* Vlerësimi i nxënësve është pjesë integrale e mësimdhënies dhe nxënies, përmes të cilit kuptojmë se sa nxënësit i kanë përfituar njohuritë, shkathtësitë, shprehitë dhe aftësitë në një fushë, lëndë dhe objektivë lëndore. “Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se në çfarë shkalle nxënësi ka zotëruar objektivat udhëzues”<sup>37</sup>. Vlerësimi ,jo vetëm që është gjykim meritior për matjen sasiore dhe cilësore të arritjeve të nxënësve, por shërben edhe si nxitje për punë të mëtutjeshme. Vlerësimi duhet të jetë i vazhdueshëm, objektiv, i saktë, i barabartë, i besueshëm, i përshtatshëm dhe në kohën e duhur e i realizuar me forma e teknika të përshtatshme me vetitë që vlerësohen. Studiues të fushës së vlerësimit japin përcaktime të ndryshme për vlerësimin:

- Vlerësimi është procesi që përcakton në ç’skallë janë realizuar objektivat mësimor (Tyler, 1950);
- Vlerësimi shërben për të përcaktuar shkallën e përmbushjes së përgjegjësisë.(Scriven, 1967);
- Një shqyrtim sistematik i vlerës dhe i meritës së një objekti.(Komiteti i Përbashkët, 1981);
- Akti i mbledhjes sistematike të informacionit përkundrejt natyrës dhe cilësisë së objekteve arsimore.(Nevo, 1995).

Në praktikën e mësimdhënies dhe nxënies zbatohen lloje të ndryshme të vlerësimit të cilat sigurojnë informata për shkallën e arritjeve të nxënësve. Në literaturë ndeshim dy qasje të klasifikimit të llojeve të

<sup>36</sup> Kraja, Dr. Musa (2006): Pedagogjia, SHBLU, Tiranë, fq.299.

<sup>37</sup> Udhëzimi administrativ MASHT [ I ] 50/04, për vlerësimin e shkallës së arritshmerisë së nxënësve.

vlerësimi: 1. Klasifikimi i llojeve të vlerësimit sipas procedurave të vlerësimit dhe 2. Klasifikimi i llojeve të vlerësimit sipas mënyrave të vlerësimit.

### ***Llojet e vlerësimit sipas procedurave të vlerësimit:***

- Vlerësimi diagnostifikues – ndihmon në zbulimin e gjendjes që kanë nxënësit në nivelin e përvetësimit të njohurive dhe në mënyrën e përcaktimit të rrugëve të përmirësimit.
- Vlerësimi klasifikues – ndihmon në vendosjen e kategorizimeve të nxënësve dhe siguron informacione për të sjellë përmirësime.
- Vlerësimi formues – mbikëqyr ecurinë, procesin, përparimin dhe siguron informacion për përmirësime.
- Vlerësimi përmbledhës – përcakton arritjet në fund të gjysëmvetorit/semestrit shkollor, vitit shkollor, programit, lëndës, modulit dhe karakterizohet me marrjen e vendimit për të gjykuar arritjet, efektshmërinë e programit etj.
- Vetëvlerësimi – individ, apo institucioni bënë gjykimin e vlerave të tij në bazë të informacionit të mbledhur nga vetë ai.

### ***Llojet e vlerësimit sipas mënyrave të administrimit të vlerësimit:***

- Vlerësimi i brendshëm – kryhet nga mësimdhënësi, aktivi profesional, shkolla. Vlerësimi i brendshëm karakterizohet me qëllimet e vlerësimit për nxënës, prindër, mësimdhënës dhe përdorues të tjerë të informacionit të vlerësimit.
- Vlerësimi i jashtëm – kryhet nga agjenci të specializuara të vlerësimit, nga vlerësues të jashtëm jashtë shkolle. Shembuj të vlerësimit të jashtëm tek ne janë vlerësimi në klasën e pestë,

vlerësimi në fund të shkollës së mesme të ulët-testi i arritëshmerisë, vlerësimi në fund të shkollës së mesme të lartë – provimi i maturës.

Procesi i vlerësimit të nxënësve kalon në disa faza. Faza e parë përcakton qëllimin e vlerësimit dhe saktëson se çka do të vlerësohet, cilat janë caqet e vlerësimit, faza e dytë përcakton metodologjinë e vlerësimit - si do të vlerësohet, cilat teknika dhe instrumente të vlerësimit do të zbatohen, faza e tretë është zbatimi i vlerësimit, faza e katërt është informimi me rezultatet e arritura, dhe faza e pestë – krahasimi i rezultateve me objektivat e vlerësimit.

Vlerësimi i nxënësve nuk mund të realizohet pa një proces paraprak të kontrollimit të njohurive, shkathtësive dhe shprehive të nxënësve, pa sigurimin e të dhënave nga matjet e ndryshme, si dhe pa testimet mbi bazat e të cilave bëhen vlerësimet<sup>38</sup>, andaj në pjesën në vijim do të ofrojmë disa të dhëna bazë që lidhen me kontrollin, matjen, testet, pyetjet/kërkesat, kriteret e vlerësimit dhe notat.

*Kontrolli.* Kontrolli është pjesë përbërëse e procesit mësimor, është procesi i mbledhjes së informatave rreth njohurive, shkathtësive dhe shprehive të nxënësve. Kontrolli “është veprim i përshkrimit të demonstrimit të nxënësit për të shtuar të nxënëit”<sup>39</sup>. Janë të njohura format e kontrollit, si: kontrolli paraprak, kontrolli sistematik, kontrolli periodik, kontrolli përfundimtar, kontrolli me shkrim etj.

*Matja.* Në mes të vlerësimit dhe matjes ekziston një lidhje e ngushtë, gjithsesi nuk janë të njëjta. “Matja është proces krahasimi nëpërmjet së cilës objektet mësimore dallohen dhe përshkruhen”<sup>40</sup>, është proces krahasimi i një sasi të njohur me një sasi të panjohur. Matja është shumë e ndërlikuar në arsim. “ Matja nuk mund të jetë e mundshme pa

---

<sup>38</sup> Kraja, Dr. Musa (2006): Pedagogjia, SHBLU, Tiranë, fq.296.

<sup>39</sup> Musai, Dr. Bardhyl (1999): Psikologji edukimi , PEGI, Tiranë, fq. 313.

<sup>40</sup> Petrela, Dr. Shpresa (2001): Manual në ndihmë të hartuesve të testeve objektive, ERIK, Tiranë, fq.6.

një standard të përcaktuar dhe të vlerësuar qartë i cili mund të përdoret si bazë e krahasimit<sup>41</sup>.

Karakteristikë e matjes është përshkrimi i rezultateve, i arritjeve duke i vënë përballë diçkaje të krahasueshme, ndërsa vlerësimi është atëherë kur gjykojmë vlerat e krahasimit, përkatësisht të matjes. Ashtu sikur vlerësimi, edhe matja përdoret për qëllime të ndryshme, qëllimet e matjes janë të njëjta me qëllimet e vlerësimit. Për realizimin e matjeve në arsim, ekzistojnë lloje të ndryshme instrumentesh. Një ndër kryesorët është testi.

*Testi dhe testimi.* Testi është instrument që përdoret për matjen e njohurive, shkathtësive, aftësive dhe karakteristikave të tjera të nxënësve. Testet përbëhen nga një numër i caktuar i kërkesave/pyetjeve, numri caktohet varësisht nga qëllimi dhe objektivat i testimit. Ndërsa, procedura e vlerësimit gjatë të cilës përdoren testet quhet testim. Testet për matjen dhe vlerësimin e njohurive, shkathtësive, shprehive e aftësive të nxënësve, ndahen në dy kategori kryesore: testet e bazuara në normë dhe testet e bazuara në kriterë. Testet e bazuara në normë përshkruajnë arritjet e një nxënësi në raport me arritjet e një grupi të nxënësve, ndërsa testet e bazuara në kriterë përshkruajnë të zotëruarit e aftësive të veçanta të nxënësit. Testet mund të jenë me gojë, me shkrim, objektive, me kombinime, me alternativa të ndryshme, testet e standardizuara dhe testet jo të standardizuara. Përveç instrumenteve të matjes, zbatohen edhe instrumentet e vrojtimit të cilat më shumë shfrytëzohen në vlerësimin e brendshëm, si: buletini i pjesëmarrjes, listë kontrolli, shkalla vlerësuese, dosja e nxënësit, etj. Testet e përgatitura nga mësimdhënësi janë për përdorim në klasë dhe duhet përdorur për të lehtësuar të nxënit e nxënësve. Testet kanë edhe efekte të padëshiruara, te një numër i nxënësve shkaktojnë ndjenja të frikës, ankthit dhe stresit.

---

<sup>41</sup> Mita, Dr. Nikoleta (2003): Vlerësimi në bazë shkolle, Qendra për Arsim e Kosovës, Prishtinë, fq.183.

*Kërkesa/pyetja.* Në literaturën profesionale të viteve të fundit pasqyrohen shpjegime të përkufizimit të termit “kërkesë ose pyetje e testit”. Në manualin në ndihmë të hartuesve të testeve objektive të Dr. Shpresa Petrela epet një përkufizimi i Osterilindit (1990), sipas të cilit, një “kërkesë ose pyetje testi në një ekzaminim të zhvillimit mendor është një njësi e matjes me një formë stimuluese dhe përshkruese për përgjigje; ajo ka si qëllim për të dhënë nga kandidati një përgjigje nga e cila nxirret një përfundim për dituritë, aftësitë, predispozicionin apo tiparet e tij”. Pra, termi “kërkesë e testit” është më i gjerë për faktin se në të përfshihen kërkesa pyetëse dhe kërkesa jo pyetëse.

*Kriteret e vlerësimit* janë mënyra se si ta gjykojmë procesin e vlerësimit, si ta gjykojmë vlerën e arritur. Kryesisht janë të njohura katër lloje të kriterëve që lidhën me vlerësimin:

1. Kriteret për përcaktimin e qëllimit të vlerësimit
2. Kriteret për hartimin e instrumenteve të vlerësimit
3. Kriteret për administrimin e procesit të vlerësimit
4. Kriteret për vlerësimin e arritjeve të nxënësve, të cilat janë të rregulluar me rregullore të veçantë dhe ndahen në kritere sipas niveleve të dijës, shkallës së arritëshmerisë – përcaktojnë notën, dispozitave të veçanta të vlerësimit – trajtimi i të vlerësuarit të nxënësve të talentuar, nxënësve me nevoja të veçanta etj.

*Nota.* Rezultati i një testimi, ushtrimi, vrojtimi në vlerësim bëhet i dukshëm përmes përcaktimit të notave. Pra, nota është njësia e vlerësimit të njohurive, shprehive, shkathtësive dhe aftësive të nxënësve. Në sistemin tonë të vlerësimit, njësia e vlerësimit është me vlerë numerike 1-5, përveç mësimit zgjedhor i cili vlerësohet me notë përshkruese – jo negative.

### III. Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi mbi praktikat dhe treguesit e procesit të vlerësimit të brendshëm është projektuar për të zbatuar një qasje të përgjithshme të metodologjisë hulumtuuese, duke u bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit që rregullon procesin e vlerësimit, dokumentimet e shkollave për vlerësimin e nxënësve, në veçanti në përpunimin e informacionit të marrë nëpërmjet takimeve me fokus grupet e interesit, si dhe nëpërmjet pyetësorëve nga anketimi i respondentëve nga të gjitha grupet e interesit të përcaktuar për përfshirje në hulumtim.

#### *a. Objekti, qëllimi dhe objektivat e hulumtimit*

*Objekti i hulumtimit.* Vlerësimi i është një nga parimet bazë të implementimit të programit mësimor. Nëpërmjet tij sigurohen të dhëna dhe tregues të ndryshëm për nivelin e arritjeve të nxënësve, për përparësitë, mangësitë dhe pengesat në mësimdhënie dhe mësimnxënie, për realizimin e planit dhe programit mësimor dhe përmbushjen e objektive mësimor, për rrugët e ngritjes së cilësisë së mësimin etj.

Vlerësimi si proces është mjaft kompleks dhe i shprehur në forma dhe mënyra të ndryshme, varësisht nga qëllimi i përdorimit. Objekt i hulumtimit tonë janë praktikat dhe treguesit e vlerësimit të brendshëm. Në fokus të hulumtimit do të jetë: informimi dhe burimet e informimit për procesin e vlerësimit, praktikat e vlerësimit të brendshëm, përputhja e vlerësimit me dokumentet bazë të vlerësimit, reagimet e grupeve të interesit për gjendjen aktuale të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.

*Qëllimi hulumtimit.* Qëllimi i hulumtimit i përgjigjet objektit të hulumtimit dhe është i orientuar në përcaktimin e drejtimeve kryesore se ku dhe si duhet të ndërhyhet në përmirësimin e procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve, si dhe në nxitjen e dialogut në mes të përfaqësuesve të shkollave, MASHT-it dhe grupeve tjera të interesit

për përmirësimin e procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve. Orientimet të cilat do t'i vëjmë në funksion të përmirësimit të procesit të vlerësimit të brendshëm, nënkuptojnë rekomandimet për institucionet shkollore dhe MASHT-in, të cilat bazohen në perspektivat e vlerësimit.

*Objektivat e hulumtimit.* Sendërtimin e qëllimit të hulumtimit kemi synuar të realizojmë përmes këtyre objektivave:

- Shqyrtimi i dokumentacionit që rregullon procesin e vlerësimit, si dhe analizën e dokumentimeve të shkollave për vlerësimin e nxënësve;
- Organizimin e takimeve me fokus grupet e interesit dhe konstatimi i përparësive dhe mangësive aktuale në procesin e vlerësimit;
- Grumbullimi i të dhënave nga faktorët relevantë të shkollës për praktikat e vlerësimit dhe konstatimi i efekteve e mangësive të tyre në rezultatet e nxënësve;
- Përpunimi i të dhënave me qëllim të konstatimit të gjendje në procesin e vlerësimit të brendshëm;
- Interpretimi i rezultateve dhe paraqitja e tyre përmes qasjes kuantitative dhe kualitative;
- Nxjerrja e përfundimeve dhe rekomandimeve për rrugët kryesore të përmirësimit të procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.

### ***b. Popullacioni dhe mostra***

Procesi i vlerësimit është i rëndësishëm për të gjithë faktorët e bashkëpunimit në shkollë. Pikërisht ,faktorët kryesor të bashkëpunimit në shkollë kanë qenë popullatat nga të cilat ekipi hulumtues ka përzgjedhur mostarat përkatëse për përfshirje në hulumtim. Nga popullatat e përcaktuara ne kemi përfshirë në hulumtim 30 zyrtarë të arsimit në nivel qendror dhe lokal, mbi 30 drejtorë të shkollave, mbi

600 mësimdhënës, mbi 600 nxënës dhe mbi 150 prindër. Përzgjedhja e shkollave është bërë nga qytetet rajonale: Prishtina, Prizreni, Gjakova, Peja, Mitrovica, Gjilani dhe Ferizaj. Kampioni i nxënësve për hulumtim është përzgjedh nga klasat e 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13-ta. Në hulumtim janë përfshirë 31 shkolla. Në shtojcën nr. 1 pasqyrohen të dhënat e shkollave të përfshira në hulumtim.

### *c. Metodatat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit*

Për të realizuar qëllimin dhe objektivat e hulumtimit, kemi shfrytëzuar qasje hulumtuese sasiore dhe cilësore. Qasja sasiore e hulumtimit është realizuar përmes anketimit dhe intervistës, ndërsa qasja cilësore është realizuar përmes metodës së fokus grupit të përqendruar, si dhe me pyetjet e parashtruara në pyetësorë të hulumtimit.

*Metoda e analizës teorike.* Përmes kësaj metode kemi analizuar punime shkencore dhe profesionale në fushën e vlerësimit, me fokus të veçantë në vlerësimin e brendshëm. Gjithashtu, kemi analizuar dokumentat ligjor që rregullojnë ligjërisht vlerësimin e nxënësve. Një analizë të veçantë u kemi bërë edhe planeve dhe programeve mësimore, pjesës ku ofrohen udhëzimet metodologjike për vlerësimin e nxënësve.

*Metoda krahasuese.* Përmes kësaj metode janë krahasuar rezultatet e të dhënave të fituara nga qasjet sasiore dhe ato cilësore të hulumtimit. Janë krahasuar dallimet në përgjigje të fituara nga nxënësit në raport me përgjigjet e mësimdhënësve, por edhe të faktorëve tjerë për të njëjtën pyetje dhe anasjelltas.

*Metoda statistikore.* Përmes kësaj metode janë paraqitur statistikiisht rezultatet e fituara përmes anketimit të nxënësve, mësimdhënësve, prindërve, drejtorëve të shkollave. Me ndihmën e kësaj metode, kemi nxjerrë tregues të ndryshëm në hulumtim, si dhe kemi bërë paraqitjen e të dhënave të hulumtimit në mënyrë tabelare dhe grafike.

*Metoda e fokus grupit.* Këtë metodë e kemi përdorur për t'i diskutuar çështjet themelore përkitazi me vlerësimin e nxënësve. Përdorimi i kësaj metode është bërë në dy punëtori. Në punëtorinë e parë kemi përfshirë pjesëmarrës nga MASHT-i, Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe ekspertë e bashkëpunëtorë të jashtëm. Ndërsa, në punëtorinë e dytë kemi përfshirë mësuesdhënës, nxënës, prindër dhe drejtorë të shkollave. Çështjet kryesore të diskutuar në punëtoritë me fokus grupet:

1. Praktikrat e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, përparësitë, dobësitë dhe mundësitë e përmirësimit të procesit të vlerësimit.
2. Udhëzimet administrative dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve.
3. Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm - mundësitë e rritjes së besueshmërisë.

Bisedat përkitazi me çështjet për diskutim janë evidentuar dhe në fund të diskutimeve, grupet punuese kanë përmbledhur idetë e shënuara, të cilat më vonë janë analizuar në tërësi.

*Teknika e intervistës.* Teknikën e intervistës e kemi përdorur me qëllim të mbledhjes së të dhënave nga drejtorët e shkollave për qasjet e shkollës , përkatësisht mësuesdhënësve në vlerësimin e arritjeve të nxënësve, trajnimin e mësuesdhënësve në fushën e vlerësimit dhe vështirësitë e mësuesdhënësve në përpilimin e testeve të vlerësimit dhe menaxhimin e tyre në klasë. Për intervistimin e drejtorëve të shkollave kemi përdorur llojin e intervistës gjysmë të strukturuar.

*Teknika e anketimit.* Teknikën e anketimit e kemi përdorur me qëllim të mbledhjes së të dhënave të çështjeve të vëna në fokus të hulumtimit dhe më vonë përpunimit të tyre përkitazi me qëndrimet, opinionet dhe shkallën e pajtueshmërisë apo jo pajtueshmërisë së respondentëve të përfshirë në hulumtim.

*Pyetësorët.* U përgatitën me lloje të ndryshme të pyetjeve dhe me përmbajtje të ndryshme. Pyetjet në pyetësor janë adresuar në katër çështje:

1. *Pyetje për të dhënat e respondentëve të përfshirë në hulumtim*
2. *Pyetje për shkallën dhe burimet e informimit mbi vlerësimin e arritjeve të nxënësve*
3. *Pyetje për praktikën e vlerësimit të arritjeve të nxënësve*
4. *Pyetje për opinionin dhe qëndrimin e respondentëve për procesin e vlerësimit*

#### **d. Kriteret për përzgjedhjen e shkollave dhe kampionit.**

Me qëllim që të fitojmë të dhëna të plota dhe gjithëpërfshirëse, kemi caktuar disa kriteret e cilave u jemi përmbajtur gjatë përzgjedhjes së shkollave që do të përfshihen në hulumtim, numrit të përafërt të drejtorëve, mësimitdhënësve, nxënësve dhe prindërve. Kriteret e përzgjedhjes së shkollave:

- 50 % e mostrës - shkolla e mesme e ulët
- 25 % e mostrës - shkolla e mesme e lartë – gjimnaz
- 25 % e mostrës - shkolla e mesme e lartë – profesionale

#### **e. Shpërndarja e respondentëve sipas kategorive të veçanta**

Përzgjedhja e shkollave është bërë në bazë të kriterëve të caktuara për nivele të shkollimit dhe për tipe të shkollave. Në lidhje me përzgjedhjen e kampionit të drejtuesve të shkollave, ekipi ynë ka përcaktuar një kriter të vetëm: të përfshihen drejtuesit e të gjitha shkollave që janë të përfshira në hulumtim. Kampioni për numrin e mësimitdhënësve dhe nxënësve të shkollës së përfshirë në hulumtim është bërë në bazë të përcaktimit paraprak të numrit të mësimitdhënësve dhe nxënësve për shkollë (25 mësimitdhënës dhe 25 nxënës), kurse përfshirja e tyre në plotësimin e pyetësorëve ka qenë tërësisht e rastit.

Përzgjedhja e kampionit të prindërve është bërë nga vetë shkollat e përfshira në hulumtim.

*Përfshirja e drejtorëve të shkollave.* Në hulumtim janë përfshirë gjithsej 30 drejtorë dhe zv.drejtorë të shkollave, prej tyre 25 të gjinisë mashkullore ose 83.33%. Mbi 43 % kanë qenë drejtues të shkollave të mesme të ulëta, 30 % drejtues të gjimnazëve dhe mbi 26 % drejtues të shkollave profesionale. Rreth 60 % e drejtuesve të shkollave janë shprehur se kanë ndjekur trajnime për metodologji të mësimdhënies, mbi 33 % për metodologji të vlerësimit<sup>42</sup> dhe mbi 76 % për udhëheqje arsimore.

*Përfshirja e mësimdhënësve.* Në hulumtim janë përfshirë 603 mësimdhënës. Prej tyre, rreth 7% janë mësues klase, 44.35 % mësimdhënës lëndor në klasat 6 – 9, mbi 26 % mësimdhënës në klasat 10-13 në gjimnaze dhe mbi 22 % mësimdhënës të klasave 10 – 13 në shkollat profesionale. Rreth 52% e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim janë të gjinisë mashkullore, ndërsa rreth 48 % , të gjinisë femërore. Në figurën 1 pasqyrohen të dhënat e përfshirjes së mësimdhënësve në hulumtim , kasifikuar sipas niveli të shkollimit ku punojnë.




Figura 1

<sup>42</sup> Trajnimet e drejtuesve të shkollave në fushën e vlerësimit kryesisht janë pjesë e programit të mendimit kritik dhe programit për udhëheqje (KEC).

Në figurën 2 pasqyrohet shpërndarja e mësimeve të përfshirë në hulumtim sipas shkallës së arsimit:




Figura 2

Mbi 72 % të mësimeve të përfshirë në hulumtim janë shprehur se kanë vijuar trajnime të ndryshme për mësime dhe mësues, 37.60 % trajnime për vlerësimin e nxënësve<sup>43</sup>, 24.13 trajnime për udhëheqje arsimore<sup>44</sup>.

*Përfshirja e nxënësve.* Në hulumtim janë përfshirë 618 nxënës. Shpërndarja e nxënësve të përfshirë në hulumtim është bërë sipas niveleve të shkollimit dhe tipeve të shkollave të mesme të larta. Kështu, 46.92 % të kampionit të nxënësve e përbëjnë nxënësit e shkollës së mesme të ulët, 26.95 % nxënësit e shkollës së mesme të lartë/gjimnaz, 26.13 % nxënësit e shkollave të mesme të larta profesionale. Mbi 36 % të nxënësve të përfshirë në hulumtim i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa mbi 63 % gjinisë femërore.

<sup>43</sup> Trajnimet e mësimeve të përfshirë në fushën e vlerësimit kryesisht janë pjesë e programit të mendimit kritik (KEC).

<sup>44</sup> Mësuesit e shkollave profesionale janë të përfshirë në % më të madhe programet për udhëheqje arsimore.

*Përfshirja e prindërve.* Në hulumtim janë përfshirë 155 prindër, mbi 62 % e tyre janë të gjinisë mashkullore, kurse mbi 37 % të gjinisë femërore. Prindërit e përfshirë në hulumtim kanë nivele të ndryshme të arsimimit: rreth 3.23% e kampionit të prindërve të përfshirë në hulumtim kanë arsimim fillor, 29.03 % arsimim të mesëm të lartë, ndërsa 67.74 % arsimiti universitar. Struktura dominuese e profesioneve të prindërve të përfshirë në hulumtim ka qenë me këtë përbërje: profesor të shkollës së mesme 16.88 %, arsimtar 13.63% dhe inxhinier 12.34 %, ekonomist 9.74 %, mjek 9.10 %, teknik të mjekësisë 6.49 %, jurist 4.54 %, mirëpo ka pasur dhe prindër me profesione tjera si: edukatorë, arkitekt, tregtar, mjeshtër të ndërtimitarisë, bibliotekar, polic, amvise etj.

#### ***f. Analiza e të dhënave dhe përgatitja e raportit***

Fillimisht është analizuar dokumentacioni zyrtar që mbulon fushën e vlerësimit, pastaj janë analizuar të dhënat e fituara nga dy punëtoritë e organizuar me fokus grupet në Prishtinë , ndërsa në fund është bërë analiza e të dhënave të fituara në pyetësorët e realizuar (plotësuar) në terren . Në veçanti, të dhënat nga terreni siguruan informacione mjaft të vlefshme ,të cilat identifikojnë vështirësitë dhe problemet që ekzistojnë në këtë fushë dhe ofrojnë mundësi për nxjerrjen e rekomandimeve për përmirësim.

Analiza e të dhënave është bërë ndaras, klasifikuar sipas faktorëve që lidhen me vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe sipas niveleve të arsimimit, si dhe janë bërë krahasimet e këtyre të dhënave . Për përpunimin e të dhënave kuantitative është përdorur programi kompjuterik SPSS 11.0 - Statistika për Windows.

## IV. Rezultatet dhe interpretimi i tyre

Në këtë kapitull do të pasqyrohen rezultatet e fituara nga hulumtimi, të cilat do të specifikohen sipas grupit të pyetjeve dhe do të pasqyrohen sipas grupit të pjesëmarrësve të përfshirë në hulumtim .Kjo ndarje e specifikuar bëhet për të parë reagimet e faktorëve të lidhur ngushtë me procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve.

### *a) Informimi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve*

Informimi në fushën e vlerësimit, por edhe në fushat tjera të arsimit, luan rolin më të madh në njohjen e fushës gjegjëse, në promovimin e aspekteve të veçanta të fushës dhe në vetëdijësimin për respektimin e kriterëve . Prandaj, për të gjitha grupet e përfshira në hulumtim kemi parashtruar pyetje në pyetësor se sa janë ata të informuar për procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe nga cilat burime është bërë informimi. Përgjithësisht, respondentet e përfshirë në hulumtim kanë dhënë përgjigjeje se janë mirë të informuar me vlerësimin e arritjeve të nxënësve. Mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave janë shprehur në përqindje më të lartë se janë mirë të informuar për procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, ndërsa nxënësit dhe prindërit janë shprehur se janë më pak të informuar për procesin e vlerësimit.

Sa i përket burimeve nga të cilat është marrë informacioni për vlerësimin e arritjeve të nxënësve, bazuar në përgjigjet e dhëna në pyetësorë, mund të themi se: *burimet kryesore të informimit të nxënësve për procesin e vlerësimit të tyre janë: Bisedat me mësimdhënësit 84.19%; Njoftimet me shkrim nga shkolla 50.41%; Bisedat me nxënës 48.26% dhe Bisedat me prindër 32.77%. Të dhënat tregojnë se rreth 50% e nxënësve të përfshirë në hulumtim shprehen se nuk kanë marrë njoftim me shkrim nga shkolla për procesin e vlerësimit të tyre, edhe pse me udhëzimin administrativ për*

vlërësimin e shkallës së arritëshmerisë së nxënësve shkollat janë të detyruara ta bëjnë një gjë të tillë.

Ndërkaq, *burimet kryesore të informimit të mësimeve për vlerësimin e arritjeve të nxënësve janë me këtë renditje: Planet dhe programet mësimore 84.19%; Udhëzimet administrative për vlerësim 50.41 %; Trajnimet për vlerësim 48.26% dhe Bisedat me kolegë 32.77%.*

Këto të dhëna dëshmojnë se mësimeve më pak i kanë shfrytëzuar për informim udhëzimet administrative për vlerësim dhe më shumë janë mbështetur në planet dhe programet mësimore, edhe pse në të gjithë vetëm udhëzime të përgjithshme për vlerësimin të cilat konsiderojmë se nuk janë të mjaftueshme<sup>45</sup>, ndërsa bisedat me kolegë për shkëmbimin e përvojave janë në nivel më të ulët.

*Burimet kryesore të informimit të drejtuesve të shkollave janë me këtë renditje: Udhëzimet administrative për vlerësim 73.33%; Planet dhe programet mësimore 66.67%; Trajnimet për vlerësim 60% dhe Bisedat me mësimeve 30.33%.*

Të dhënat tregojnë se drejtorët e shkollave janë më të prirur në konsultimin e udhëzimeve dhe dokumenteve tjera zyrtare dhe më pak në komunikim me mësimeve të cilët ballafaqohen drejtpërdrejtë me këtë proces. Nga përgjigjet e nxënësve dhe prindërve është vërejtur se drejtorët e shkollave pak angazhohen në shpërndarjen e informatave me shkrim për vlerësimin dhe rezultatet e arritura tek faktorët tjerë të interesit, në veçanti tek prindërit.

Nga analiza e rezultateve mësojmë se *burimet kryesore të informimit të prindërve për vlerësimin e arritjeve të nxënësve janë: Bisedat me mësimeve 91.61%; Bisedat me fëmijët e tyre 81.93%; Bisedat me kolegë – prindër 39.35% dhe) Njoftimet me shkrim nga shkolla 18.06%.*

Rezultatet nxjerrin një pikë mjaft të dobët të shkollave që nuk e praktikojnë njoftimin me shkrim të prindërve për procedurat e vlerësimin të arritjeve dhe për rezultatet e arritura.

---

<sup>45</sup> Më gjerësisht, udhëzimet për vlerësim në planet dhe programet mësimore për klasat 1 -12/13.

Burimet e informimit për procesin e vlerësimit të nxënësve që më pak shfrytëzohen nga grupet e interesit të përfshira në hulumtim janë: revistat, televizioni, interneti.

Për të marrë informacion se sa e njohin mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave bazën ligjore<sup>46</sup> për vlerësimin e nxënësve, kemi kërkuar nga ata që të përgjigjen për shkallën e njohjës së kësaj baze. Rezultatet tregojnë se drejtuesit e shkollave prijnë në shkallë të lartë në njohjen e bazës ligjore përkundrejt mësimdhënësve.

### ***b) Praktikë shkollorë në vlerësimin e nxënësve***

Për të gjitha grupet e përfshira në hulumtim, në pyetësorë kemi parashtruar pyetje për praktikën e vlerësimit të brendshëm të nxënësve, për kriteret bazë të vlerësimit, për reagimet kur nuk pajtohen me vlerësimin, për praktikën e vendosjes gjatë kohës së testimit të arritjeve të nxënësve me notë.

Në pyetjen: *Si bëhet më së shpeshti vlerësimi i arritjeve të nxënësve me notë?* - kemi marrë rezultate të përafërta në mes të grupeve të interesit të përfshira në hulumtim. Në këtë pyetje respondentët e përfshirë në hulumtim kanë pasur mundësi të zgjedhin deri në tri përgjigje nga alternativat e specifikuar: vlerësimi me gojë – pyetje/përgjigje në tabelë, me teste, me detyra të shtëpisë, me portfolio, me ese, dhe me mundësi për të shënuar vetë respondentët. Rezultatet tregojnë se kryesisht aplikohen: vlerësimi me gojë – pyetje përgjigje në tabelë, vlerësimi me teste dhe vlerësimi me anë të angazhimi gjatë gjithë kohës.

Sipas faktorëve të bashkëpunimit të përfshirë në hulumtim, vlerësimet e nxënësve me anë të detyrave të shtëpisë, me portfolio, me ese, me projekte, me punë hulumtuese etj, janë fare pak të shprehura në

---

<sup>46</sup> MASHT ka nxjerrë disa udhëzime administrative të cilat e rregullojnë procesin e vlerësimit, si: Udhëzimi Administrativ për vlerësimin e shkollës së arritshmerisë së nxënësve, Udhëzimi Administrativ për avancimin e nxënësve të talentuar, Udhëzimin Administrativ për vlerësimin e maturës, Udhëzimi Administrativ për vlerësimet përfundimtare në shkollat profesionale.

praktikat tona shkollore. Është interesant fakti se nxënësit, në mundësinë për të veçuar mënyrat e vlerësimit më të përshtatshme për ta, kanë veçuar pikërisht praktikat aktuale të vlerësimit që zbatohen në shkollat tona, pra kanë veçuar: 1. Vlerësimi me gojë – pyetje përgjegje në tabelë, 72 % e nxënësve; 2. Vlerësimi me angazhim gjatë gjithë kohës, 53.63 % e nxënëve, dhe 3. Vlerësimi me teste, 49.83 % e nxënësve.

Objektiv bazë i çdo vlerësimi “është përcaktimi i shkallës me të cilën nxënësi realizon objektivat e parashikuara”<sup>47</sup>, prandaj informimi për kriterët e vlerësimit ishte njëra nga pyetjet e hulumtimit tonë. Mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave përgjigjen pozitivisht në këtë pyetje, duke i thënë PO informimit për kriterët e vlerësimit të nxënësve me notë, mirëpo nuk kanë specifikuar se si e bëjnë informimin e nxënësve për kriterët e vlerësimit me notë. Ndërsa jo të gjithë nxënësit dhe prindërit janë përgjigjur me PO informimit të tyre për kriteret e vlerësimit me notë.

Për të marrë përgjigje me të plotë rreth informimit për kriteret e vlerësimit, ne kemi kërkuar që përveç përgjegjës me PO dhe JO, të sqarojnë: Nëse PO, atëherë si si bëhet informimi? Nga kjo pyetje kemi marrë përgjigje të ndryshme nga të cilat mësojmë se për kriteret e vlerësimit, nxënësit dhe prindërit informohen individualisht nga mësimdhënësit dhe vetëm përmes formës gojore. Nxënësit janë ata të cilët në këtë pyetje kanë dhënë përgjigje interesante. Nga përgjigjet e nxënësve mësojmë se mbi 50 % e nxënësve nuk i kanë të qarta kriteret e vlerësimit, që nënkupton se mësimdhënësit nuk e kanë bërë si duhet informimin e nxënësve për kriteret e vlerësimit. Nxënësit thonë se për kriteret e vlerësimit informohemi kështu:

- *Informohemi se si do të na pyesin dhe kur do të na pyesin. Informohemi se duhet të jemi aktiv në çdo orë mësimi, se do të pyesim me gojë ose me test etj. Thjesht informohemi se kemi test*

<sup>47</sup> Grup autorësh: Vlerësimi i arsimit 3, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, fq.122, 2003.

*në një ditë të caktuar. Informohemi, por kriteret e profesorëve kanë dallime të mëdha. Ne nuk e dimë pse, mirëpo duhet tu përmbahemi kritereve të secilit profesor<sup>48</sup>.*

Me qëllim që të arrijmë përgjigjeje më të plotë për kriterët e vlerësimit nga mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave kemi kërkuar që të veçojnë kriteret bazë ku ata mbështetën për të bërë vlerësimin e arritjeve të nxënësve me notë. Nga shumica e mësimdhënësive dhe drejtorëve kemi marrë këto përgjigjeje: në bazë të angazhimit gjatë gjithë kohës, punës praktike dhe teorike, përsëritjeve, detyrave të shtëpisë, komunikimit, testit, vlerësimit me gojë, interesimit, disiplinës së nxënësve dhe vijimit të rregullt dhe përkushtimit. Një numër i vogël i mësimdhënësve kanë thënë se për kriter marrin njohuritë, aftësitë e nxënësve për të bërë krahasimin, analizën, sintezën, punën në grup<sup>49</sup> etj.

Standardet për nxënësit janë kritere që përcaktojnë se ç'duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit në një disiplinë mësimore. Ato përdoren për të vlerësuar përparimin e nxënësit në lidhje me standardin e caktuar të përmbajtjes<sup>50</sup>. Nga përgjigjet e mësimdhënësve, mësojmë se fare pak mësimdhënës mbështetën në standardet e arritshmerisë dhe në rezultatet e pritura të vendosura në programet mësimore për të bërë vlerësimin e arritjeve të nxënësve.

Në praktikat shkollore kemi reagime të ndryshme të grupeve të interesit kur nxënësit nuk pajtohen me vlerësimin e mësimdhënësit. Për të marrë informacion për praktikatat e reagimeve për rastet kur nxënësit nuk pajtohen me vlerësimin e mësimdhënësve, ne kemi shtruar pyetjen: *Si reagoni më së shpeshti kur nuk pajtoheni me vlerësimin e mësimdhënësve?* Në këtë pyetje mbi 80 % e nxënësve

<sup>48</sup> Përgjigjet e nxënësve në pyetjen e tipit të hapur: Si ju informojnë mësimdhënësit për kriteret e vlerësimit?

<sup>49</sup> Përgjigjet e mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave në kërkesën tonë për të veçuar kriteret bazë ku mbështetën për të bërë vlerësimin e arritjeve të nxënësve me notë.

<sup>50</sup> Grup autorësh: Vlerësimi i arsimit 3, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, fq.112, 2003.

janë përgjigjur se kërkojnë të pyetën edhe njëherë. Po ashtu edhe mësimehmënesit, 76 % prej tyre janë përgjigjur se nëse nxënësit nuk pajtohen me vlerësimin e tyre, kërkojnë nga nxënësit që të pyetën edhe njëherë.

Për të marrë informacion se si organizohen dhe menaxhohen testet e realizuara nga mësimehmënesit, kemi parashtruar pyetjen për nxënës, mësimehmënes dhe drejtues të shkollave: *Si vendosën nxënësit gjatë kohës së testimit të arritjeve të tyre me notë? Nxënësit dhe drejtuesit e shkollave në përqindje më të madhe, mbi 50 % thonë se vlerësimi me teste bëhet në klasë – si gjatë procesit mësimehmënes, ndërsa mbi 57 % e mësimehmënesve thonë se vendosjen e nxënësve gjatë kohës së testimit të arritjeve të tyre me notë e bëjnë në klasë – me një vendosje të veçantë.*

Në përgjithësi, nxënësit dhe prindërit janë shprehur se janë të pakënaqur me mënyrën e organizimit dhe menaxhimit të testimit të arritjeve me notë, sepse në të shumtën e rasteve testet nuk përgatitëten si duhet, bëhen me shkrim aty për aty, nuk kanë kohë të mjaftueshme dhe nuk bëhet punë e pavaruar nga nxënësit, shpeshëherë ndodhë që të përcillen testet nga klasa në klasë.

***c) Reagimet, opinionet e faktorëve relevantë të shkollës për procesin e vlerësimit***

Për të marrë reagime, opinione të faktorëve relevant të shkollës (nxënës, mësimehmënes, drejtues të shkollës për procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe prindër), kemi shtruar në pyetësor disa pyetje, në të cilat janë kërkuar reagimet, opinionet e tyre për : *vëmendjes që i kushton shkolla përkatësisht mësimehmënesit procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve; ngarkesën e nxënësve gjatë kohës së vlerësimit me notë, si dhe për shkallën e pajtimit ose mospajtimit me disa çështje të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.*

## 1. *Vëmendja që i kushton shkolla procesit të vlerësimit*

Për hulumtimin e shkallës së vëmendjes së shkollës për procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, në pyetësor kemi bërë përpjekje që t'i pasqyrojmë elementet më kryesore të vlerësimit që duhet të kenë vëmendje të posaçme nga shkolla dhe kemi kërkuar që përgjigjet të jenë me shprehjet: **gjithmonë, nganjëherë, rrallë, kurrë, nuk e di**. Pyetja është adresuar kështu: *Sa vëmendje i kushton shkolla - mësimdhënësit procesit të vlerësimit të nxënësve?* Pastaj janë përshkruar çështjet më kryesore që lidhën me procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe që meritojnë vëmendje të veçantë:

<i>1. Analizon me organe profesionale rezultatet e pritshme me rezultatet e arritura në mësim.</i>
<i>2. Bënë planifikim për vlerësimin e rezultateve të nxënësve.</i>
<i>3. Përcjellë përparimin e nxënësve.</i>
<i>4. Publikon rezultatet e arritura</i>
<i>5. Diskuton me nxënës për problemet rreth vlerësimit të rezultateve të tyre - Organizon debate</i>
<i>6. Komunikon me prindër për çështje të vlerësimit të nxënësve</i>
<i>7. Ndhmon zhvillimin e aftësive të nxënësve për të vlerësuar përparimin e tyre nëpërmjet vetëvlerësimit</i>
<i>8. Motivon nxënësit dhe mësimdhënësit me rezultate të larta.</i>
<i>9. Propozon mundësi përmirësimi dhe ofron mundësi trajnimi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve.</i>
<i>10. Udhëheqë procesin e përmirësimit.</i>

Tabela 1 <sup>51</sup>

<sup>51</sup> Në tabelën nr. 1 janë çështjet për të cilat është kërkuar përgjigje nga mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave.

Përgjigjet e mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave në përgjithësi janë pozitive për vëmendjen që i kushtojnë procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe dallojnë varësisht nga kontekstet shkollore.

Mësimdhënësit kanë veçuar dy çështje të rëndësishme që lidhen me procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, të cilave me pak u kushton vëmendje shkolla<sup>52</sup>. Mbi 36 % e mësimdhënësve shprehën se shkolla rrallë i kushton vëmendje motivimit të nxënësve dhe mësimdhënësve me rezultate të larta, mbi 10 % të mësimdhënësve shprehën se shkolla këtë nuk e bënë kurrë. Ndërsa mbi 25 % e mësimdhënësve shprehën se shkolla rrallë propozon mundësi përmirësimi dhe ofron mundësi trajnimi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve, lidhur më këtë mbi 11 % të mësimdhënësve shprehën se shkolla këtë nuk e bënë kurrë.

Edhe drejtuesit e shkollave kanë veçuar dy çështje të rëndësishme që lidhen me procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, të cilave me pak u kushton vëmendje shkolla. Mbi 20 % e drejtuesve të shkollave shprehën se shkolla rrallë i kushton vëmendje komunikimit me prindër për çështje të vlerësimit të nxënësve, mbi 8 % të drejtuesve të shkollave shprehën se shkolla këtë nuk e bënë kurrë. Ndërsa mbi 25 % shprehën se shkolla rrallë propozon mundësi përmirësimi dhe ofron mundësi trajnimi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve, mbi 5 % të drejtuesve të shkollave shprehën se shkolla këtë nuk e bënë kurrë.

Për vëmendjen që i kushton shkolla procesit të vlerësimit të nxënësve, nga nxënësit dhe prindërit kemi kërkuar që të përgjigjen në gjashtë çështje të rëndësishme që lidhen ngusht me procesin e vlerësimit. Çështjet në të cilat janë thirrur të japin mendimin nxënësit dhe prindërit janë paraqitur në tabelën 2. Edhe nga nxënësit dhe prindërit

---

<sup>52</sup> Dy çështjet e veçuara nga mësimdhënësit që më pak u kushtohet vëmendje nga shkolla, lidhen me procesin e menaxhimit dhe drejtimit të shkollës.

kemi kërkuar që të ofrojnë përgjigjeje me shprehjet: **gjithmonë, nganjëherë, rrallë, kurrë, nuk e di**, shkolla:

<i>1. Përcjellë përparimin e nxënësve.</i>
<i>2. Publikon rezultatet e arritura</i>
<i>3. Diskuton me nxënës për problemet rreth vlerësimit të rezultateve të tyre. Organizon debate për vlerësim</i>
<i>4. Komunikon me prindër për çështje të vlerësimit të nxënësve</i>
<i>5. Ndhmon zhvillimin e aftësive të nxënësve për të vlerësuar përparimin e tyre nëpërmjet vetëvlerësimit</i>
<i>6. Motivon nxënësit dhe mësimsdhënësit me rezultate të larta.</i>

Tabela 2

Përgjigjejet e nxënësve dhe prindërve për vëmendjen që i kushton shkolla procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve kanë dallime me përgjigjet e mësimsdhënësve dhe drejtuesve të shkollave. Analiza e rezultateve tregon se mbi 29 % e nxënësve shprehen se shkolla gjithmonë i kushton vëmendje procesit të vlerësimit të nxënësve, mbi 34 % shprehen nganjëherë, mbi 18 % shprehen rrallë, mbi 10 % shprehen se kjo nuk ndodhë asnjëherë apo kurrë dhe mbi 8 % shprehen se nuk kanë njohuri.

*Nxënësit* kanë veçuar dy çështje të cilave rrallë apo kurrë nuk u kushtonjnë vëmendje shkollat. Mbi 25 % te nxënësve shprehen se shkolla rrallë ndihmon zhvillimin e aftësive të nxënësve për të vlerësuar përparimin e tyre nëpërmjet vetëvlerësimit, ndërsa mbi 10 % shprehen së shkollat këtë angazhim nuk e bëjnë kurrë. Mbi 27 % e nxënësve shprehen se në shkollë rrallë diskutohen apo organizohen debate me nxënës për çështjet e vlerësimit, për problemet rreth vlerësimit të rezultateve të tyre, , ndërsa mbi 11 % thonë se kjo nuk realizohet kurrë.

*Prindërit* kanë veçuar dy çështje të rëndësishme që lidhen me procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, të cilave rrallë u kushtojnë vëmendje shkollat. Mbi 26 % e tyre shprehen se shkolla rrallë komunikon me ta për çështje të vlerësimit të nxënësve, ndërsa mbi 9% shprehen se shkolla këtë nuk e bënë kurrë. Mbi 25 % e prindërve shprehen se shkolla rrallë ndihmon zhvillimin e aftësive të nxënësve për të vlerësuar përparimin e tyre nëpërmjet vetëvlerësimit, ndërsa mbi 13 % shprehen se shkolla këtë nuk e bënë kurrë.

## **2. Ngarkesa e nxënësve gjatë kohës së vlerësimit**

Lidhur me ngarkesën e nxënësve gjatë kohës së vlerësimit me nota, kemi bërë një pyetje të adresuar për të gjithë respondentët e përfshirë në hulumtim. Nxënësit e shkollës së mesme të lartë profesionale janë shprehur në përqindje me të lartë se janë mjaft të ngarkuar gjatë kohës së vlerësimit me notë, këtë e thonë 47.74 % e tyre, ndërsa 30.97 % shprehen se janë të ngarkuar. Kurse 44 % e nxënësve të gjimnazit shprehen se janë mjaft të ngarkuar, ndërsa 35.34 % shprehen se janë të ngarkuar. Për dallim prej tyre, 35 % të nxënësve të shkollës së mesme të ulët shprehen se janë mjaft të ngarkuar, ndërsa 43.33 % shprehen se janë të ngarkuar.

Për të marrë përgjigje më të plotë rreth ngarkesës së nxënësve gjatë kohës së vlerësimit me notë, kemi kërkuar nga nxënësit që të arsyetojnë përgjigjen e dhënë. Disa nga arsyetimet e dhëna :

- Jemi të ngarkuar për arsye se vlerësimi i nxënësve fillon në të njëjtën kohë nga të gjithë profesorët. Nuk pyetemi deri në fund të gjysëmvetorit ose vitit, pastaj pyetemi në të gjitha lëndët. Ndodhë që brenda një ditë të pyetemi me notë në tri ose katër lëndë mësimore. Orari i vlerësimit të nxënësve është i pakoordinuar .

- Jemi të ngarkuar sepse nuk ka parapërgatitje të duhura për vlerësimin me notë.

Po ashtu, edhe mësime të drejtuesit e shkollave dhe prindërit, në përqindje më të madhe shprehin se nxënësit gjatë kohës së vlerësimit me notë janë mjaft të ngarkuar dhe të ngarkuar. Disa nga arsyetimet e mësime të drejtuesve për përgjigjet rreth ngarkesës së nxënësve gjatë kohës së vlerësimit me notë:

- Nxënësit janë dhe janë të ngarkuar sepse ka raste që në një ditë kanë dy ose tri teste;
- Nxënësit janë mjaft të ngarkuar sepse plani dhe programi mësimor është mjaft të ngjeshur.
- Nxënësit janë të ngarkuar sepse gjatë vlerësimit shpesh kanë trajtim jo të mirë nga mësime të drejtuesit.

Përgjigjet e mësime të drejtuesve tregojnë se shkollat nuk praktikojnë të harmonizojnë kohën e vlerësimeve, sidomos kur nxënësit vlerësohen për nota përfundimtare. Po ashtu, arsyetimet e mësime të drejtuesve lidhen më shumë me programet mësimore dhe më pak me qasjen e tyre në vlerësim.

Drejtuesit e shkollave kanë dhënë kryesisht këto arsyeime në përgjigjet e tyre:

- Realizimi i testeve shpesh bëhet në një periudhë të caktuar, në shumicën e lëndëve ndodh që në një paralele të ketë deri në tri teste në ditë
- Nuk ka koordinim të mësime të drejtuesve sa i përket vlerësimit të nxënësve
- Vlerësimi i nxënësve nuk bëhet në mënyrë sistematike dhe të planifikuar, por në formë fushate në fund të gjysmëvjetorit ose vitit shkollor;
- Nxënësit janë të ngarkuar sepse ora mësimore efektive nuk kalon mbi 30 minuta, në klasa ka raste kur ka nga 40 nxënës, në raste të veçanta edhe më shumë

- Planet dhe programet e ngarkuara dhe mungesa e teksteve në shkollat profesionale

Reagimet e drejtorëve tregojnë se në shumicën e shkollave mungon koordinimi i mësimdhënësve lidhur me vlerësimin e nxënësve. Kjo nënkupton se mungojnë edhe iniciativat e drejtorëve për ta menaxhuar më mirë procesin e vlerësimit në shkollë.

### ***3. Shprehja shkallës së pajtimit ose e mospajtimit me disa çështje të vlerësimit***

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në mësim është proces që mësimdhënësit e realizojnë kur mbledhin të dhëna për shkallën e arritshmerisë së nxënësve, ” kur sintetizojnë dhe interpretojnë informacionin që u shërben atyre për të marrë vendime”<sup>53</sup>. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në mësim nuk është duke u monitoruar. Me qëllim që t’i vërtetojmë disa konstatime të ndjeshme të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në mësim, kemi kërkuar nga mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave që të shprehin shkallën e pajtimit ose të mospajtimit me konstatimet e vëna në pyetësor për disa çështje të vlerësimit të nxënësve në mësim. *Kemi kërkuar që përgjigjet të jenë me shprehjet: fare nuk pajtohem, nuk pajtohem, pajtohem, pajtohem plotësisht, dhe nuk e di.*

---

<sup>53</sup> Mita, Dr. Nikoleta: Vlerësimi në bazë shkolle , Qendra për Arsim e Kosovës, Prishtinë, 2003, fq.193.

*Legjenda:*

1. *Udhëzimi administrativ për vlerësimin e shkallës së arritshmerisë së nxënësve dhe planet e programet mësimore ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për procesin e vlerësimit të nxënësve.*
2. *Vlerësimi fillestar në fillim të vitit shkollor ofron bazë të plotë dhe të saktë për planifikim të përshtatshëm të mësimit gjatë vitit shkollor.*
3. *Testet që i hartojnë mësimdhënësit janë kryesisht me pyetje alternative dhe bazohen në njohje dhe në të kuptuar.*
4. *Nxënësit gjatë një jave mësimi nuk kanë më shumë se tri testime.*
5. *Në praktikat shkollore vërehen tendenca të barazimit të vlerësimit me testimin.*
6. *Vlerësimi i arritjeve të nxënësve nuk është i standardizuar.*
7. *Programet e aftësimin të mësimdhënëseve nuk kanë ofruar mundësi të mjaftueshme për avancimin e praktikave të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në shkollë.*

Për të gjitha konstatimet e vëna në pyetësor kemi marrë shakallë të lartë të pajtimit/pajtimit plotësisht, si nga mësimdhënësit ashtu edhe nga drejtorët e shkollave. Shkalla e lartë e pajtueshmërisë me këto konstatime reflekton problemet me të cilat ballafaqohet sot procesi i vlerësimit të arritjeve të nxënësve. Pra, është në rritje tendenca e barazimit të vlerësimit me testimin, testet që i hartojnë mësimdhënësit janë kryesisht me pyetje alternative dhe bazohen në njohje dhe në të kuptuar dhe përgjithësisht vlerësimi i arritjeve të nxënësve nuk është i standardizuar, prandaj edhe ka dallime jashtëzakonisht të mëdha të rezultateve nga vlerësimi i brendshëm me atë të jashtëm, por edhe brenda vlerësimit të brendshëm në të njëjtën shkollë.

#### 4. *Probleme të ngritura*

Nga të gjithë respondentet e përfshirë në hulumtim, kemi kërkuar që të shprehin ide, mendime dhe sugjerime për çështje të ndryshme që lidhën me vlerësimin e nxënësve. Disa nga mendimet, idetë, sugjerimet që janë dhënë nga një numër relativisht i madh i respondentëve, do t'i prezantojmë ashtu si i kanë dhënë vetë ata.

Opinione të nxënësve<sup>54</sup>:

- Nxënësit duhet të jenë me të interesuar për mësim. Interesimi ynë mund t'i nxit profesorët të punojnë më shumë me ne dhe të na vlerësojnë me kritere. Në shkollën tonë interesimi i nxënësve për mësim ka rënë shumë, kjo ka bërë që rezultatet e shumicës së nxënësve të jenë të ulëta.
- Problemet e vlerësimit lidhen me mosvijueshmërinë e rregullt të nxënësve por edhe të mësimdhënësve, si dhe me mungesën e disiplinës.
- Disa mësimdhënës kërkojnë që të shkojmë në kurse të cilat ata i organizojnë dhe në bazë të kësaj na vlerësojnë. Ka mësimdhënës që në fillim të vitit na i thyejnë shpresat.
- Mësimdhënësit nuk duhet të na vlerësojnë vetëm me teste, sepse në paralele është numri i madh i nxënësve, kopjimi në mes të nxënësve është shumë i madh.
- Vlerësimi i disa mësimdhënësve është më se i gabuar, sepse më shumë u pëlqen që brenda një ore mësimi ti zënë nxënësit e papërgatitur dhe ta vlerësojnë me notë të dobët. Mësimdhënësit duhet të bëjnë çmos për të nxjerrë dijet që kanë nxënësit, duke i dhënë mundësi të shumta për tu pyetur.
- Nuk respektohen rregullat shkollore, profesorët e mbajnë mësimin dhe ikin, nuk u intereson se çfarë po bëjnë nxënësit dhe sa po përparojnë ata në mësim. Disa vlerësojnë duke u mbështetur në notat paraprake në ditar.
- Marrë në përgjithësi, vlerësimi i nxënësve nuk është korrekt, ngase ka intervenime të profesorëve, ka kopjime të nxënësve. Të rrallë

<sup>54</sup> Kemi veçuar disa prej opinioneve të nxënësve që janë veçuar nga shumica e nxënësve që kanë dhënë kontributin e tyre dhe që prekin temën e hulumtimit.

janë ata profesorë në shkollën tonë që bëjnë vlerësime reale. Nxënësit i marrin notat e para dhe më nuk pyeten, sepse nuk kanë kohë profesorët, nxënësit që gjatë gjithë vitit shkollor fare nuk mësojnë, në fund të vitit kalojnë sikur nxënësit që kanë mësuar gjatë gjithë vitit, etj.

- Shkolla duhet t'i motivojë nxënësit e dalluar, p.sh. t'u jap mirënjohje, lëvdata, sepse stimulime të tilla përdorën kudo në botë dhe kanë efekte pozitive, kjo bënë që tek nxënësit të ngjallet fryma garuese. Duhet te ketë gara të diturisë në shkolla.
- Ka raste kur profesorët në të njëjtën kohë e bëjnë vlerësimin e nxënësve. Kjo është një mbingarkesë, të themi që shpesh kalon në monotoni dhe nuk kanë motiv për mësim.
- Arsimtari nëse është nervoz nuk duhet të shprehë mllëfin në nxënës. Nuk duhet të pyetemi te tabela me gojë, kjo formë është stres, ankth për ne. Mund të flasim, të bisedojmë dhe komunikojmë më lirshëm nga banka.
- Kriteri i vlerësimit të nxënësve është tepër i ulët, sepse në fund të vitit notat i kanë sikur nxënësit që kanë mësuar si ata që fare nuk kanë mësuar. Kjo është e padrejtë, sepse nxënësit e mirë demoralizohen.
- Mësimdhënësit duhet të bëjnë parapërgatitje për test, në mënyrë që nxënësit të jenë më të përgatitur për ditën e testimit me notë. Pyetjet të jenë sa më të qarta dhe të kuptueshme.
- Profesorët duhet të jenë në gjendje të menaxhojnë lëndën e tyre mësimore, të mos i vlerësojnë nxënësit vetëm me një test në fund të gjysëmvetorit apo vitit shkollor, siç është duke ndodhur tani.
- Disa mësimdhënës të shkollës sonë, notat e mira i japin vetëm kur janë në disponim, ndikohen nga lidhjet familjare dhe ka raste që e notojnë nxënësin pa e pyetur fare. Ka raste kur kemi pësuar keq për shkak se nxënësit kanë bërë zhurmë dhe si pasojë e kësaj profesorët janë bërë nervoz dhe kanë dhënë nota të dobëta.
- Të gjitha kriteret që vendosen në fillim të vitit shkollor, thyhen nga vetë profesorët. Fatkeqësisht! Në fund të vitit shkollor fryhen notat tej mase, ndodhë që nota 1 të shndërrohet ne notën 5, që në të shumtën e rasteve është pa meritë.

Opinione të mësimeve<sup>55</sup>:

- Udhëzimet për vlerësim janë në rregull, por aplikimi i tyre nuk është në nivel. Nuk jemi aftësuar për qasjen aplikative të tyre.
- Suksesi i nxënësve nuk është në nivel, sepse numri i nxënësve në paralele është i madh, planet dhe programet janë shumë të ngarkuara, orët mësimore janë të shkurtra – diku edhe 25 min.
- Përgatitja jo e mirë e mësimeve, jo korrektësia, jo serioziteti në punë, jo disiplina në orë të mësimi si dhe jo mbajtja e përgatitjeve ditore për mësim kanë bërë që ne të kemi rezultate jo të mira në mësim.
- Kemi një dukuri jo të mirë në shkolla sa i përket vlerësimit të nxënësve, janë bërë “ modë “ intervenimet e brendshme të mësimeve lidhur me notat e nxënësve. Deri më tani nuk shohim ndonjë mekanizëm të përshtatshëm për ta eliminuar këtë dukuri.
- Janë dy çështje bazë që ndikojnë që nxënësit të kenë rezultate jo të mira në vlerësimin e jashtëm. E para, niveli i ulët i njohurive të arritura gjatë shkollimit. E dyta, realizimi i pjesërisht të planeve dhe programeve mësimore. Sa i përket vlerësimit të nxënësve në shkollë, ai është duke u bërë gati në mënyrë fushate, kryesisht në fund të gjysëmvetorit ose vitit, merret vetëm një kriter!!!
- Menaxhimi dhe udhëheqja e dobët e shkollës është duke ndikuar shumë në rezultate.
- Duhet organizuar seminare, trajnime dhe punëtori me të gjithë mësuesit rreth vlerësimit, por edhe me të gjithë hartuesit e testeve të arritshmërisë dhe maturës.
- Rezultatet e ulëta të nxënësve në mësim janë si rezultat i mungesës së motivimit të nxënësve dhe mësimeve, si rezultat i mos interesimit të nxënësve për mësim, i mungesës së perspektivës për të ardhmen dhe i kriterëve të dobëta në shkolla.
- Është një problem i madh në shkollat tona. Një numër i nxënësve kanë vështirësi të mëdha në shkrim dhe lexim dhe kanë arritur deri në shkollën e mesme të lartë. Me këta nxënës askush nuk merret, secili mësues donë me ecë me programin zyrtar.

<sup>55</sup> Kemi veçuar opinionet e mësimeve që në një mënyrë formulimi janë dhënë nga shumica e mësimeve, si dhe disa individuale që kemi vlerësuar se janë me interes për hulumtimin.

- Në shkollën tonë, besoj edhe në shumicën e shkollave të Kosovës, vlerësimi i arritjeve të nxënësve nuk është real, sepse në fund të vitit shkollor ka ndryshim jashtëzakonisht të madh sa i përket notimit të nxënësve, diku rreth 70 % të nxënësve vlerësohen pa kritere.
- Mendojë se nuk duhet të përcillen( kalohen ) nxënësit që kanë nota të dobëta nga klasa e tretë deri në të pestën, kjo duhet të vlejë vetëm për klasën e parë dhe të dytë. Nëse vazhdohet kështu, mund t'i kontribuojmë analfabetizmit.
- Numri i madh i nxënësve në paralele dhe rënia e interesimit të nxënësve për mësim kanë ndikuar në uljen e rezultateve në mësim.
- Mediat elektronike, sidomos TV, fare pak i kushtojnë hapësirë arsimit, nevojave dhe problemeve. Ato më shumë i kushtojnë kujdes serialeve që kanë vlera të ulëta edukative.

#### Opinione të drejtuesve të shkollave<sup>56</sup>:

- Interesimi shumë i ulët i nxënësve për mësim gjatë shkollimit, disiplina në nivelin të ulët, puna e arsimtarëve jo në nivel, interesimi i ulët i prindërve, mungesa e llogaridhënies, pranimi i arsimtareve pa kritere, mungesa e mbikëqyrjes së punës në shkolla etj., kanë bërë që rezultatet të jenë jo të mira dhe të kemi një gjendje të përgjithshme jo të mirë në shkolla . Prandaj, nëse duam ta avansojmë shkollën dhe arsimin, kërkohet urgjentisht të merren masa konkrete nga organet kompetente, të gjinden forma të rritjes së përgjegjësisë ndaj drejtuesve të shkollave, mësimit dhe nxënësve. Ta dini, gjendja po shkon duke u keqësuar çdo ditë e më shumë!
- Që udhëzimet për vlerësim të gjejnë zbatim në praktikë, duhet të mbahen në shkolla diskutime me mësimit dhe nxënësve se si duhet të bëhet vlerësimi i nxënësve, duke zbatuar udhëzimin administrative për vlerësim. Mendojë se këtë më se miri do të kenë mundësi ta bëjë drejtori i shkollës, zv. drejtori, pedagogu

<sup>56</sup> Kemi veçuar disa opinione të drejtuesve të shkollave që janë përsëritur më shumë dhe që lidhen me temën e hulumtimit.

(nëse ka shkolla pedagog), natyrisht pasi që këta të jenë të trajnuar për këtë punë.

- Vlerësimi i jashtëm është duke u ballafaquar me vështirësi të mëdha, meqenëse administruesit dhe vëzhguesit e procesit të testimave janë të pakujdesshëm, nuk bëhet parapërgatitja e nxënësve për një vlerësim të tillë, nuk ka informim të plotë për këtë formë të vlerësimit, nuk është duke u realizuar plani dhe programi nga mësimdhënësit etj.
- Për një numër të madh të mësimdhënësve, nota ende ka mbetur e vetmja “ armë “ për të “ruajtur” autoritetin.

Opinionet e prindërve<sup>57</sup>:

- Në çdo shkollë duhet të ketë rregulla, parime dhe kritere të cilat e rregullojnë organizimin e punës në shkollë. Të dallohen dhe motivohen nxënësit e mirë nga nxënësit jo të mirë ( në mësim ) e jo siç është bërë shprehi që nxënësit me shumë të dobëta ta kalojnë vitin pa meritë.
- Pengesë për arritjen e rezultateve të larta në mësim janë mungesa e teksteve shkollore në shkollën profesionale, profesorët japin shënime, nxënësit i mësojnë ose i përgjysmojnë edhe ato pak shënime. Duhet të hiqet diktimi në shkolla, nxënësit duhet të nxiten të lexojnë dhe përpunojnë materiale të ndryshme në mënyrë që të pasurojnë logjiken dhe të menduarit.
- Disa mësimdhënës janë të orientuar të mbajnë kurse private, pak po i përkushtohen punës në shkollë dhe vlerësimin po e bëjnë më shumë nga puna në kurse private.
- Nuk është duke funksionuar trekëndëshi i bashkëpunimit: prind – nxënës – mësimdhënës. Edhe menaxhimi i shkollës nuk është në nivel të duhur.
- Disa arsimtar janë duke bërë teste shkel e shko, sa për sy e faqe, vetëm që ta vendosin një notë për nxënësit. Më mirë të mos i bëjnë këto teste kështu fare.

<sup>57</sup> Edhe nga opinionet e prindërve kemi veçuar disa më të rëndësishmet që lidhen me temën e hulumtimit tonë.

## V. Përfundime dhe rekomandime

### Përfundime

Hulumtimi ka pasur për qëllim që të diagnostifikojë gjendjen aktuale të sfidave dhe problemeve të vlerësimit të shkollës së arritshmerisë së nxënësve dhe të orientojë drejtimet kryesore se ku dhe si duhet të ndërhyhet në përmirësimin e procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve. *Përfundimet kryesore të dala nga analiza e të dhënave të hulumtimit ishin këto:*

**Shumica** e faktorëve të bashkëpunimit në shkollë janë shprehur se janë mirë të informuar për procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve. Mirëpo, këtë nuk e kanë arsyetuar në çështje të veçanta të vlerësimit të arritjeve të nxënësve si: kriteret për vlerësim, standardet e arritshmerisë etj, sepse më shumë flasin për kohën dhe mënyrën e vlerësimit.

Nxënësit dhe prindërit, për dallim nga mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave, janë më pak të informuar për procesin e vlerësimit.

**Burimet** kryesore të informimit për procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve janë: udhëzimet administrative për vlerësim, planet dhe programet mësimore, trajnimet, bisedat me mësimdhënësit, njoftimet me shkrim nga shkolla, bisedat me nxënës dhe bisedat me prindër. Burimet e informimit për procesin e vlerësimit të nxënësve që më pak shfrytëzohen nga grupet e interesit të përfshira në hulumtim janë: revistat, televizioni, interneti. Vetëm 50 % të nxënësve të përfshirë në hulumtim konfirmojnë se shkollat bëjnë njoftim formal me shkrim për procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve. Ndërsa vetëm 18.06 % të prindërve konfirmojnë se njoftohen me shkrim nga shkolla për procesin e vlerësimit të nxënësve.

Praktikat e vlerësimit që kryesisht aplikohen në shkollat tona janë: vlerësimi me gojë – pyetje përgjigje në tabelë, vlerësimi me teste dhe vlerësimi me anë të angazhimi gjatë gjithë kohës. Në nivelin I (kl. 1-5) testet që i aplikojnë mësimmshënësit kryesisht janë pjesë e fletoreve të punës mësimore. Në nivelin II (kl.6-9) dhe në nivelin III (kl.10-12/13) mësimmshënësit kryesisht i hartojnë testet në mënyrë individuale, pak ka përpjekje që testet të hartohen në bashkëpunim me aktivet profesionale brenda shkollës. Një numër fare i vogël i respondentëve të përfshirë në hulumtim kanë veçuar se vlerësimi i arritjeve të nxënësve bëhet me anë të detyrave të shtëpisë, me portfolio, me ese, me projekte, me punë hulumtuese etj.

Vlerësimi formues nuk aplikohet me qëllim që të kontrollohet përparimi i nxënies së nxënësve gjatë procesit mësimor, të motivojë nxënësit për mësim , të përmirësojë planifikimin dhe metodologjinë e mësimmshënies, të kontrollohet realizimi i objektivave mësimore, por aplikohet vetëm për të vënë notat në ditar – libër të klasës.

Vlerësimi përmbledhës në shkolla nuk siguron informata të mjaftueshme për të vlerësuar përvetësimin e objektivave të lëndës dhe të efektshmerisë së programit mësimor. Këtë e vërtetojnë edhe rezultatet në vlerësimet e jashtme, krahasuar me vlerësimin e brendshëm.

Kriterët e vlerësimit nuk kuptohen në thelb nga mësimmshënësit dhe drejtuesit e shkollave, dhe shumë më pak nga nxënësit dhe prindërit. Respondentët e përfshirë në hulumtim më shumë flasin për kohën dhe mënyrën e vlerësimit se sa për kriterët bazë të vlerësimit. Fare pak mësimmshënës mbështetën në rezultatet e pritura të programeve mësimore për të bërë vlerësimin e arritjeve të nxënësve.

Vlerësimi me notë i nxënësve nëpërmjet testeve, kryesisht bëhet në klasë – si gjatë procesit mësimor. Kjo ka bërë që një numër i madh i nxënësve dhe prinderve të jenë të pakënaqur me mënyrën e organizimit dhe menaxhimit të testeve në klasë.

█ Fare pak ka shembuj të burimeve të shkruara që mund të jenë dëshmi për realizimin e çështjeve bazë që lidhën me aktivitetet që shkolla i ndërmerrë për përmirësimin e procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.

█ Shumica e respondentëve të përfshirë në hulumtim mendojnë se nxënësit janë mjaft të ngarkuar, përkatësisht të ngarkuar gjatë kohës së vlerësimit me notë. Arsyetimet bazë për ngarkesën e nxënësve gjatë kohës së vlerësimit të nxënësve me notë janë:

- vlerësimi i nxënësve fillon në të njëjtën kohë nga të gjithë mësimdhënësit
- shkollat nuk kanë orar të koordinuar të vlerësimit të nxënësve me nota
- programet mësimore janë të ngarkuara
- orët e shkurtëra mësimore
- numri i madh i nxënësve në klasë etj.

█ Nxënësit e shkollës së mesme të lartë – profesionale, janë shprehur në shkallë më të lartë se janë mjaft të ngarkuar gjatë kohës së vlerësimit me notë, këtë e arsyetojnë më pamundësinë për të përvetësuar programin mësimor për shkak të mungesës së mësimit praktik, mjeteve të konkretizimit dhe për shkak të numrit të madh të nxënësve në klasë.

█ Testet e përgatitura nga mësimdhënësit për vlerësimin e arritjeve të nxënësve, kryesisht janë me pyetje alternative dhe bazohen në njohje<sup>58</sup> dhe në të kuptuar. Vetë mësimdhënësit e pranojnë se vlerësimi i arritjeve të nxënësve në shkolla nuk është i standardizuar.

█ Në praktikat shkollore vërehen tendenca të barazimit të vlerësimit me testimin.

---

<sup>58</sup> Këtë e vërteton edhe raporti i Institutit të Londrës për vlerësimin e hapave të parë të programeve kombëtare në Kosovë: Vlerësimi në klasë përkonte me mbamendjen e informacioneve ose me aftësinë për llogaritje numerike (fq.18).

Programet e deritanishme të aftësimin të mësimdhënësve nuk kanë ofruar mundësi të mjaftueshme për avancimin e praktikave të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në shkollë.

Të gjitha grupet e interesit të përfshira në hulumtim kanë ngritur një numër të caktuar të problemeve të lidhura me vlerësimin e arritjeve të nxënësve. Problemet e ngritura tregojnë se vlerësimi i arritjeve të nxënësve është "krizë". Gjendja është si rezultat i humbjes së interesimit të nxënësve për mësim, si rezultat i punës jo në nivel të mësimdhënësit, si rezultat i mosnjohjes në thelb të kriterëve bazë të vlerësimit, si rezultat i presionit të padrejtë të vet mësimdhënësit ndaj kolegëve të tyre për ti ngritur notat e pamerituara, si rezultat i presionit të drejtuesve të shkollave që duan kalueshmëri të lartë të nxënësve me justifikim të "ngritjes" së performancës së shkollës, si rezultat i presionit të prindërve që kërkojnë nota të pamerituara për fëmijët e tyre, si rezultat i numrit të madh të nxënësve në klasë – bazuar në kushtet ekzistuese dhe si rezultat menaxhimit jo cilësor të procesit të vlerësimit me bazë shkollë.

## Rekomandime

Për të dhënë disa orientime në funksion të përmirësimit të procesit të vlerësimit të nxënësve, kemi nxjerrë disa rekomandime, të cilat nëse do të respektohen, besojmë se do të reflektojnë pozitivisht në përmirësimin e politikave dhe praktikave të vlerësimit.

### ***Rekomandimet<sup>59</sup> për mësimdhënës dhe drejtues të shkollave:***

- Procesi i vlerësimit të brendshëm të arritjeve të nxënësve duhet të jetë i përshtatshëm, i drejtë, i saktë, i realizuar në mënyrë sistematike me llojllojshmëri të teknikave dhe instrumenteve të

---

<sup>59</sup> Rekomandimet për mësimdhënës dhe drejtues të shkollave janë detyra të përhershme, të cilat duhet të përmbushën në proces të punës.

matjes e vlerësimit. Duhet pasur kujdes që format e vlerësimit të brendshëm të plotësojnë e jo t'i imitojnë format e vlerësimit të jashtëm<sup>60</sup>.

- Procesi i vlerësimit të arritjeve të nxënësve të jetë i planifikuar, i koordinuar dhe të mos ketë ndryshime të dukshme të shpeshtësisë së vlerësimit nga klasa në klasë, “vlerësimi i nxënësve nuk duron fushatë, por duhet të jetë i përhershëm dhe në harmoni si kohë, si metodë vlerësimi”<sup>61</sup>.
- Praktikant e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në shkollë të mbështeten jo vetëm në njohje dhe në të kuptuar të lëndës, por edhe në shkallë tjera të arritjes, si zbatim, analizë, sintezë dhe vlerësim, në mënyrë që arritjet e nxënësve tanë të jenë të matshme dhe të krahasueshme me arritjet e nxënësve në rajon dhe më gjerë.
- Vlerësimi i brendshëm i nxënësve të pasqyrojë arritjet e nxënësve në harmoni me standardet e përmbajtjes dhe të arritshmerisë për klasë dhe nivele. “Vlerësimi duhet shoqëruar realisht me shpjegim, që të këtë vlerë për nxënësin e vlerësuar dhe klasën në tërësi apo grup”<sup>62</sup>.
- Testet të zënë vend të veçantë në vlerësimin e arritjeve të nxënësve, por jo të barazohen me vlerësimin. Testet të përgatiten mirë në aspektin përmbajtjesor dhe teknik, të përmbajnë forma të ndryshme të kërkesave/pyetjeve dhe shkallë të ndryshme të vështirësive. Testet të menaxhohen mirë në klasë, në çdo mënyrë menaxhimi i testit në klasë të shmang mundësitë e kopjimit të nxënësve dhe bartjes së testeve në paralele tjera të së njëjtë klasë. Për këtë është më se e nevojshme që shkollat të hartojnë planin e zbatimit të testeve që kanë për qëllim vlerësimin përfundimtar të

<sup>60</sup> Instituti i Edukimit - Universitetit i Londrës: Plan programet kombëtare në Kosovë – vlerësimi i hapave të parë, Prishtinë, 2005, fq. 13.

<sup>61</sup> Kraja, Prof.dr.Musa (2008): Pedagogji e zbatuar, GEER, Tiranë, fq.366.

<sup>62</sup> Kraja, Prof.dr.Musa (2008): Pedagogji e zbatuar, GEER, Tiranë, fq.367.

nxënësve me notë në përfundim të gjysmë vjetorit apo vitit shkollor.

- Të planifikohen dhe aplikohen garat e diturisë si mobilizuese dhe nxitëse për përvetësimin e programit mësimor, në mënyrë që nxënësi, duke qenë në garë me vetveten dhe të tjerët ,mund të përparojë në mësim.
- Institucionet shkollore t'i kushtojnë vëmendje të veçantë përparimit të nxënësve, analizës së rezultateve të pritshme me rezultatet e arritura, debateve për çështje të vlerësimit. Institucionet shkollore të krijojnë ura bashkëpunimi dhe rrjetëzimi me mësimdhënës dhe ekspertë të fushës së vlerësimit.

### ***Rekomandimet<sup>63</sup> për MASHT-in dhe IPK-në:***

- Të bëhet rishikimi i udhëzimeve që e rregullojnë procesin e vlerësimit të nxënësve.
- ***Arsyetim:*** *Udhëzimet e tanishme nuk i përmbushin nevojat praktike të vlerësimit të nxënësve, kanë shënuar disa mangësi të cilat duhet të eliminohen me qëllim të ngritjes së cilësisë në procesin e vlerësimit.*
- Të hartohet një sistemi funksional për monitorimin e procesit të vlerësimit.
- ***Arsyetim:*** *Aktualisht procesi mësimor nuk është duke u monitoruar, pra as procesi i vlerësimit. Nuk mund të flasim për cilësinë e mësimin në arsimin parauniversitar, pa e monitoruar atë.*
- Të hartohet një programi funksional dhe koherent për aftësimin e mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave në fushën e vlerësimit dhe në funksion të realizimit të standardeve të përbajtjes dhe të arritshmerisë për klasë dhe nivele.

---

<sup>63</sup> Rekomandimet për MASHT dhe IPK duhet të analizohen për të përcaktuar bartësit, përgjegjësit kryesor dhe afati i përmbushjes së rekomandimeve.

- **Arsyetim:** Kriterët e vlerësimit nuk kuptohen në thelb nga mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave . Fare pak mësimdhënës mbështetën në standardet e arritshmerisë dhe në rezultatet e pritura të programeve mësimore për të bërë vlerësimin e arritjeve të nxënësve.
- Të ngritet një grup profesional për futjen në zbatim të teknikave të vlerësimit formativ shkollat e Kosovës.
- **Arsyetim:** Zbatimi i vlerësimit formativ në shkolla do të reflektojë pozitivisht tek rezultatet e të nxënësve.
- Të rishikohen dhe vendosen standardet e përmbajtjes dhe arritshmerisë.
- **Arsyetim:** Standardet e përmbajtës dhe standardet e arritshmerisë janë bazë “për një sistem të drejtë e unik të vlerësimit të jashtëm e të brendshëm në klasat 5, 9, 12/13”<sup>64</sup>.
- Të përgatitën për nxënës, mësimdhënës, prindër dhe për palë tjera të interesit udhëzime, doracakë e informatorë të ndryshëm për standardet e përmbajtjes, të arritshmerisë dhe për procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm.
- **Arsyetim:** Dokumentet e tilla do të ndihmonin në shkallën e informimit, vetëdijesimit dhe në nxitjen e dialogut të përfaqësuesve të shkollave, MASHT-it dhe grupeve të tjera të interesit për procesin e vlerësimit.
- Të hulumtohen në shkallë vendi shkaqet e humbjes së interesimit të nxënësve për mësim.
- **Arsyetim:** Të gjitha grupet e interesit të përfshira në hulumtimin tonë, janë shprehur se rezultatet në mësim kanë rënë për shkak të humbjes së interesimit të nxënësve për mësim. Edhe rezultatet nga vlerësimet e jashtme tregojnë se cilësia në arsim është e ulët, prandaj hulumtimi i shkaqeve të humbjes së interesimit të nxënësve për mësim dhe hulumtimet në fusha të tjera të arsimit do të sigurojnë informata për rrugët e përmirësimit në arsim.

<sup>64</sup> Instituti i Edukimit - Universitetit i Londrës: Plan programet kombëtare në Kosovë – vlerësimi i hapave të parë, Prishtinë, 2005, fq. 14

## Referencat

1. Grup autorësh: Plan programet kombëtare në Kosovë – vlerësimi i hapave të parë, Instituti i Edukimit, Universiteti i Londrës,, Prishtinë, 2005.
2. Grup autorësh: Përmirësimi i performancës së organizatës, ADEA, Prishtinë, 2005.
3. Grup autorësh: Vlerësimi i arsimit 3, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2003.
4. Grup autorësh: Arsimit bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor ( Raport nga hulumtimi ), KEC dhe forumi 2015, Prishtinë, 2006.
5. Projekti KOSVET: Korniza kombëtare e sigurimit të cilësisë për AAP, KOSVET, Prishtinë, Janar 2006.
6. Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës, Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës, Prishtinë, shtator 2001.
7. Kraja, Dr. Musa (2006): Pedagogjia, SHBLU, Tiranë.
8. Kraja, Prof.dr.Musa (2008): Pedagogji e zbatuar, GEER, Tiranë.
9. *MASHT (2008): Udhëzimet Administrative për Arsimin dhe Aftësimin Parauniversitar, Prishtinë*
10. Mita, Dr. Nikoleta: Vlerësimi në bazë shkolle, Qendra për Arsim e Kosovës, Prishtinë, 2003.
11. Musai, Dr.Bardhyl: Psikologji edukimi, PEGI, Tiranë, 1999.
12. Tamo, Adem: Testimi i diturisë, teoria dhe praktika, Libri Universitar, Tiranë 1995.
13. Zeneli, Isuf (2003): Bazat e standardizimit në arsim, Libri Shkollor, Prishtinë
14. Zyra Rajonale e Arsimit në Prishtinë: Raporti nga analiza e rezultateve të testit të arritshmerisë me rezultatet e vlerësimit të brendshëm, Prishtinë, 2006.



Shtojca: *Lista e shkollave të përfshira në hulumtim*

<b>Nr</b>	<b>Shkolla</b>	<b>Tipi i shkollës</b>	<b>Rajoni</b>
1.	Kuvendi i Arbërit	Gjimnaz	Ferizaj
2.	Faik Konica	Shkollë e mesme ekonomike	“
3.	Gjon Sereqi	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	“
4.	Jeronim De Rada	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	“
5.	Thimi Mitko	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	Gjilan
6.	Musa Zajmi	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	“
7.	Zenel Hajdini	Gjimnaz	“
8.	Mehmet Isai	Shkollë e mesme teknike	“
9.	Yll Morina	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	Gjakovë
10.	Emin Duraku	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	“
11.	Hajdar Dushi	Gjimnaz	“
12.	Kadri Kusari	Shkollë e mesme ekonomike	“
13.	Ibrahim Fehmiu	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	Prizren
14.	Jeta e Re	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	“
15.	Gjon Buzuku	Gjimnaz	“
16.	Leon Motronil	Shkollë e mesme e mjekësisë	“
17.	Ramiz Sadiku	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	Pejë
18.	V.P.Shkodrani	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	“
19.	Shaban Spahija	Shkollë e mesme teknike	“
20.	Ali Hadri	Shkollë e mesme ekonomike	“
21.	Avdullah Shabani	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	Mitrovicë
22.	Meto Bajraktari	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	“
23.	Frang Bardhi	Gjimnaz	“
24.	Arkitekt Sinani	Shkollë e mesme teknike	“
25.	Hoxhë Kadri Prishtina	Shkollë e mesme e lartë ekonomike	Prishtinë
26.	Eqrem Çabej	Gjimnaz	“
27.	Gjergj Fishta	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	“
28.	Hasan Prishtina	Shkollë fillore dhe e mesme e ulët	“
29.	Hivzi Sylejmani	Gjimnaz	“
30.	Gj.K.Skënderbeu	Gjimnaz	“
31.	Fan.S.Noli	Shkollë e mesme teknike	“